ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL NË KOHË NDRYSHIMESH

Mbështetja e mësuesve dhe drejtuesve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar (IAP) si të përballen me ndryshimin.

DOKUMENT POLITIKASH
(Policy Paper)

01

Hartuar nga:
Prof.Asoc.Dr. Tomi TRESKA
Dr. Zenel SINA

Procesi u koordinua nga:
MSC. Kledia LIKA
PhD Student. Vahidije KADIU

Tiranë, 2022

Botimi i Serisë "Dokumenti i Politikave" të Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar (CSL)".

Kjo është një iniciativë e Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar (CSL)" , ku çdo vit do të përzgjidhet një temë e caktuar që lidhet me arsimin parauniversitar, lidershipin e menaxhimin e shkollës.

Përmes analizës së politikave të ndjekura do të ofrohen rekomandime e sugjerime përkatëse për të përmirësuar apo ndërmarrë politika të reja nga këndvështrimi i ekspertëve dhe studiuesve në këtë fushë.

Biografi e autorëve:

Prof. Asoc. Dr. Tomi TRESKA, Lektor pranë Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve në Universitetin Europian të Tiranës UET.

Prof.As.Dr. Treska ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie në nivel universitar, përvojë të pasur pune me organizata dhe agjenci kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e trajnimeve dhe të ngritjes së kapaciteteve të drejtuesve të shkollave dhe mësuesve për tematika që lidhen me administrimin e arsimit, metodologjitë e mësimdhënies, partneritetin shkollë – familje, "qeverisjen e mirë", etj. Prof. Asoc. Dr. Tomi Treska është hartues i shumë analizave, studimeve, raporteve, vëzhgimeve. Ka publikuar artikuj shkencorë në revista të njohura shkencore brenda dhe jashtë vendit. Prej vitit 2005 e në vijim është autor i teksteve të historisë për sistemin e Arsimit Parauniversitar.

Dr. Zenel SINA, lektor pranë Departamentit të Pedagogjisë të Fakultetit të Edukimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Gjatë karrierës së tij akademike ka drejtuar Departamentin e Pedagogjisë, Dr. Zenel Sina ka ideuar dhe drejtuar Qendrën për Edukim në Vazhdim në Universitetin ku punon. Z.Sina ka përvoje të gjatë në arsimin në Shqipëri duke përfshirë role si mësues, drejtues shkolle, trajner dhe aktivist në shoqërinë civile, kryesisht në fushën e edukimit. Kontributi më i spikatur i tij është në drejtim të zhvillimit profesional të mësuesve, prindërimit dhe në fushën e të nxënit. Ai ka publikuar një sërë artikujsh në revista shkencore dhe konferenca rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
Dr. Zenel SINA është autor dhe redaktor i disa librave e revistave për fëmijë.

TABELA E PËRMBATJES

Seksion 1: Hyrja.....4

Seksion II: Zhvillimi profesional i mësuesve në një

mjedis që ndryshon vazhdimisht.....5

Seksion III. Politikat aktuale të zhvillimit

profesional të mësuesve dhe drejtuesve në Shqipëri.....7

Seksion IV: Sfidat e zhvillimit profesional të

vazhdueshëm të punonjësve arsimorë.....10

Seksion V: Konkluzione.....10

Seksion VI: Rekomandimet.....15

Section VII: Referencat:.....18

Seksion 1: Hyrja

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve dhe drejtuesve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar është një proces kyç në rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Ky proces merr një rëndësi akoma më të madhe kur mjedisi i të nxënit është në ndryshim të vazhdueshëm për shkaqe të ndryshme si ngjarje të mëdha globale, zhvillimet e shpejta në teknologji, diversiteti në klasa, globalizimi etj. Në këtë kuadër, agjencitë përgjegjëse publike dhe jopublike në Shqipëri zbatojnë politika dhe programe të ndryshme që synojnë zhvillimin profesional të mësuesve e drejtuesve. Ato konsiderohen shumë të rëndësishme nga mësuesit dhe drejtuesit e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri, por njëkohësisht ata shprehen që si pasojë e mjedisit që ndryshon vazhdimisht po shfaqen paradigma e qasje të reja në arsim. Në këtë mënyrë, duhet të ndryshojnë, pasurohen dhe të përshtaten edhe tematikat, praktikat dhe aspektet metodologjike në sistemin e trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve e drejtuesve. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve mësuesit dhe drejtuesit kanë nevojë për më shumë tema trajnimi që janë të lidhura me realitetin dinamik ku po jetojnë dhe që i vijnë në ndihmë atyre për zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies e të nxënit.Për të dalë më në pah nevojat e mësuesve dhe drejtuesve për zhvillim profesional në një mjedis që ndryshon vazhdimisht dhe duke synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit, Qendra "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" (CSL) hartoi këtë dokument politikash (policy paper) me qëllim përmirësimin e këtij procesi.

Ky Dokument Politikash (Policy Paper) synon të paraqesë një analizë të përgjithshme të aspekteve dhe sfidave të zhvillimit profesional të mësuesve/drejtuesve në një mjedis që ndryshon vazhdimisht, përballë sfidave të globalizmit e teknologjive të informacionit, si dhe duke u bazuar në opinionet e mësuesve/drejtueve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar. Të dhënat që janë përdorur për të mbështetur analizën, konkluzionet dhe rekomandimet, të paraqitur në këtë dokument politikash, janë marrë nga rreth 800 mësues/drejtues të Institucioneve të Arsimit

Parauniversitar në Shqipëri. Ata morën pjesë në ciklin e trajnimit online "Mësimdhënia dhe të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht" në datë 06 Prill-24 Maj 2021 zhvilluar nga Programi për Zhvillimin Profesional të Vazhdueshëm (CPD) të Shkollës së Drejtorëve.Në këtë mënyrë duke përdorur këto të dhëna parësore, dokumenti i politikave është në gjendje të ofrojë disa rekomandime për të përmirësuar më tej zhvillimin profesional të mësuesve e drejtuesve të shkollave, në kuadër të sfidave të mjedisit global të mësimdhënies dhe të nxënit.

Seksion II: Zhvillimi profesional i mësuesve në një mjedis që ndryshon vazhdimisht.

Mësuesi global *mund të përkufizohet si një qytetar global dhe një mësues universal, i cili zotëron kualifikimet dhe kompetencat e kërkuara nga globalizimi, njeh ndryshimet dhe zhvillimet globale dhe përmirëson veten në përputhje me rrethanat. (Canli, S., & Demirtas, H. (2018).*
Nxënësi global *është zotërues i kompetencave globale. Keto kompetenca përfshijnë njohuritë për vendet, kulturat e çështjet universale dhe aftësitë për t'u angazhuar me përgjegjësi dhe efektivitet në një mjedis global (Rizvi & Lingard, 2009; OECD & Asia Society, 2018; US DOE, 2018).*

Pandemia e Covid-19 ndikoi në mënyrë të dukshme në sistemin arsimor në të gjithë botën. Në këtë mënyrë doli në pah sesa e rëndësishme është që mësuesit të kenë aftësitë e duhura për t'u përshtatur sa më shpejt, të përmirësohen dhe të përsosin praktikat e tyre të mësimdhënies e të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht. Krahas ngjarjeve të mëdha globale si fatkeqësitë natyrore, sociale dhe politike apo epidemitë, një nga faktorët që po ndikon në ndryshimin e mjedisit të mësimdhënies e të nxënit është edhe zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe rritja e diversitetit të klasave ku mësojnë fëmijë me prejardhje të ndryshme gjeografike, etnike e karakteristika të veçanta psiko-sociale. Kjo ka bërë që këta elementë të kenë rol domethënës në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit. Tashmë është një fakt i njohur se fëmijët nuk mësojnë më vetëm brenda ambienteve të shkollave por në çdo mjedis tjetër ku ata ndodhen, si në shtëpi apo në komunitetet që i rrethojnë.

Të gjitha ndryshimet e sipërmendura e bëjnë të domosdoshme nevojën që zhvillimi profesional i mësuesve të jetë një proces dinamik, që zgjat gjatë gjithë karrierës së tyre dhe si rrjedhojë nuk duhet të lidhet vetëm me trajnime rutinë mbi tematika të caktuara. Kjo është e rëndësishme nëse sistemet arsimore synojnë që mësuesit të jenë të përgatitur për t'u përshtatur siç duhet në një mjedis që ndryshon vazhdimisht dhe të mos reagojnë në mënyrë mekanike kur ato ndodhin dhe prekin mikromjedisin e shkollës. Si rrjedhojë, zhvillimi profesional i vazhdueshëm është thelbësor për t'i mbështetur mësuesit dhe drejtuesit në mënyrë që ata të zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre dhe të arrijnë t'u përgjigjen siç duhet përgjatë karrierës së tyre ndryshimeve të realitetit. Këto ndryshime shpesh sjellin nevoja për të ndërtuar aftësitë e nxënësve për t'i përballuar ato. Në këtë periudhë po ndodh një evolucion lidhur me trajnimet e mësuesve, duke kaluar nga "zhvillimi profesional" në të "mësuarin profesional". Dallimi mes këtyre koncepteve lidhet me faktin se "zhvillimi profesional" përfshin kryesisht aktivitete që ndodhin një herë të vetme ku ofrohet informacion i njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit dhe mbështetet në ekspertizën e atij që po e zhvillon atë. Ndërsa "i mësuari profesional" mbështetet tek nevojat specifike të të mësuarit për komunitetet e shkollave dhe është i individualizuar sipas pikave të forta dhe kërkesave të mësuesve.

Për shkak të rëndësisë së veçantë të rritjes profesionale të mësuesve, në të gjithë botën po shtrohet shqetësimi për mënyrën se si po organizohet dhe zhvillohet ky proces. Disa nga metodat që përdoren aktualisht për zhvillim profesional, si për shembull trajnimet e shkurtra, kanë rezultuar se nuk janë shumë të efektshme që mësuesit të kenë njohuritë e nevojshme dhe të jenë të përgatitur përballë një mjedisi që ndryshon vazhdimisht. Orientimi i aktiviteteve për zhvillim profesional të vazhdueshëm drejt formave që janë më efektive dhe të qëndrueshme janë elementë kyç për të siguruar një proces me cilësi të mësimdhënies dhe të nxënit.

Në këtë kuadër, sistemet arsimore në botë po rishikojnë mënyrat se si organizohet zhvillimi profesional i mësuesve duke sjellë praktika të reja efektive, të cilat janë cilësuar si të suksesshme në bazë të të dhënave të tyre.

Në Japoni është zhvilluar një rrjet aktiv i mësuesve për zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional që nxit bisedat dhe të mësuarit ndërmjet stafeve, inkurajon të mësuarin aktiv në mënyrë individuale dhe profesionale, nxit komunikimin ndërmjet stafeve pedagogjike dhe përmirëson rezultatet e nxënësve. Kjo iniciativë përfshin; caktimin e ditëve të posaçme për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me rritjen profesionale të mësuesve, të cilat janë në përputhje me Planin Strategjik të Shkollës për zhvillimin e stafit pedagogjik, organizimin e takimeve mes stafit në formën e seminareve dhe workshop-eve që bëjnë të mundur diskutimet profesionale; realizimin e workshop-eve brenda shkollës me sesione të ndryshme që bëjnë të mundur zhvillimin e aftësive të ndryshme; krijimin e e programeve të ndryshme të mentorimit dhe këshillimit; anëtarësimin në rrjete, qendra profesionale dhe burime të ndryshme informacioni në internet që ofrojnë mundësi për të zgjeruar njohuritë dhe shkëmbimin e eksperiencave apo praktikave më të mira.Ndërkohë në Portugali është krijuar një rrjet prej 91 qendrash rajonale të trajnimit që ofrojnë kurse në përputhje me nevojat lokale të shkollave dhe stafeve mësimore. Këto qendra trajnimi kanë për detyrë që të shkojnë në shkolla të ndryshme, në nivel rajoni, në mënyrë që të informohen mbi projektet e tyre pedagogjike dhe kurrikulare. Njëkohësisht ata vlerësojnë nevojat për zhvillim profesional të mësuesve për t'u ofruar më pas trajnime në përputhje me to. Secila nga qendrat e trajnimit, e cila ka stafin drejtues dhe administrativ, është e financuar nga Ministria e Arsimit të Portugalisë. Sidoqoftë, vlerësimet e këtij modeli në Portugali kanë identifikuar si sfidën kryesore faktin që ndjekja e programeve që ato ofronin ishte e varur nga pjesëmarrja vullnetare e mësuesve pasi ata mbaronin orët e mësimit, në mbrëmje ose gjatë fundjavave.

Nga ana tjetër në Kolumbi po zbatohet programi "Të mësojmë të gjithë", që është një nismë e mentorimit dhe këshillimit të mësuesve, e cila është përhapur gjerësisht në të gjithë vendin që nga viti 2012. Kjo nismë përfshin aktivitete të zhvillimit profesional, shpërndarjen e materialeve për mësuesit dhe nxënësit, si dhe mbështetje e këshillim të vazhdueshëm të mësuesve sipas nevojave. Në thelb ajo mbështetet mbi një "model kaskadë", ku trajnerët udhëzojnë mentorët, të cilët më pas e zbatojnë këtë parim me mësuesit. Trajnerët kryejnë cikle të zhvillimit profesional për

grupet e mentorëve për t'i ndihmuar ata që më pas të krijojnë nëpërmjet këshillimit e mentorimit një sërë aftësish e kompetencash tek mësuesit. Mentorët vëzhgojnë praktikat e mësuesve, japin sugjerime mbi strategjitë pedagogjike dhe organizojnë aktivitete me kolegët e tyre për të diskutuar tema që lidhen me mësimdhënien. Gjithashtu ata mbështesin dhe realizojnë vlerësimin e nxënësve, zgjedhjen e materialeve dhe teksteve shkollore. Ky program ka në qendër të vëmendjes shkollat me arritjet më të ulëta dhe ka patur ndikim të ndjeshëm veçanërisht në shkollat rurale.Në vitin 2020, programi ka punuar me më shumë se 4000 shkolla publike në të gjithë vendin, ku më tepër se 100 trajnerë kanë udhëzuar 4237 mentorë, duke bërë të mundur që këta të japin mbështetjen e tyre për 64,000 mësues.

Në dokumentin "Rritja profesionale e mësuesve në kohë ndryshimesh" (OECD, 2020), jepen sugjerime se si zhvillimi profesional mund të bëhet një proces dinamik dhe efektiv për mësuesit. Në këtë rast sugjerohet që: shkollat duhet të planifikojnë kohë për mësuesit lidhur me zhvillimin e tyre profesional; mësuesit duhet të orientohen drejt aktiviteteve më efektive dhe jo tradicionale të zhvillimit profesional; promovimi i bashkëpunimit profesional mes mësuesve duhet të jetë nëpërmjet një mbështetje të strukturuar dhe në koordinim me strukturat përgjegjëse; udhëzime që nxisin përdorimin e teknologjisë (online) për trajnimet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional në mënyrë që mësuesit të mos jenë të mbingarkuar.

Seksion III. Politikat aktuale të zhvillimit profesional të mësuesve/drejtuesit në Shqipëri.

Zhvillimi profesional i mësuesve/drejtuesve është një proces me anën e të cilit politikëbërësit përcjellin vizionin e tyre të gjerë, ofrojnë informacionin e njohuritë e duhura dhe sigurojnë formimin dhe drejtimin e duhur profesional për mësuesit dhe drejtuesit. Në këtë rast është pikërisht mënyra e drejtimit që nxit zhvillimin e tyre në një fushë të caktuar, çka ndikon më pas në përmirësimin e kurrikulës dhe procesit të mësimdhënies e të nxënit (Hassel, 1999; Gordon, 2004). Zhvillimi profesional lidhet gjithashtu me eksperiencën dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës (Gordon, 2004), ku mësuesit shprehen se kanë nevojë për një mbështetje të vazhdueshme në mënyrë që të zbatojnë shprehitë e konceptet e përvetësuara gjatë trajnimeve. Për këtë arsye është e rëndësishme të bëhet vlerësimi i modeleve dhe programeve të trajnimit në mënyrë të vazhdueshme, duke pasur në qendër të vëmendjes rolin që ato luajnë në zhvillimin profesional të mësuesve. Ky aspekt i rëndësishëm përmendet edhe në Ligjin Nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), ku theksohet roli i mësuesit dhe ndikimi i tij në cilësinë e arsimit, duke e konsideruar si çelësin e suksesit për çdo reformë arsimore.

Gjithashtu, zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga objektivat kryesore të Strategjive Kombëtare të Arsimit Parauniversitar ndër vite (2004-2015; 2009-2013; 2014-2020; 2020-2026), ku janë ndërmarrë një sërë reformash dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka bashkëpunuar me aktorë të ndryshëm për realizimin e tyre. Ndër arritjet kryesore mund të përmenden: a) ngritja e portalit online mbi ofrimin e trajnimeve për mësuesit dhe deri tek identifikimi i nevojave të tyre për zhvillim profesional sipas një plani 4-vjeçar; 2) krijimi i rrjeteve profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë, ku aktualisht veprojnë rreth 1200 rrjete profesionale dhe 3) ofrimi i trajnimeve të financuara nga shteti (të paktën 3 ditë në vit, 51% të trajnimeve në sistemin e arsimit parauniversitar) (shih: Raporti i Arritjeve ASCAP 2017-2020; Udhëzimi Nr. 20.01.2017).Shkolla e Drejtorëve, themeluar me datë 18.01.2019, nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin profesional të drejtuesve dhe mësuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar përmes Programit të Trajnimit të Detyrueshëm dhe Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm. Sot, në Shqipëri janë trajnuar dhe certifikuar 183 drejtues, nëndrejtues dhe aspirantë. Nga shqyrtimi i dokumentave strategjikë dhe vlerësimit të zbatimit të tyre është vërejtur se zhvillimi profesional i mësuesve ka qenë dhe mbetet në qendër të vëmendjes së Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin, por sërish ka problematika që duhen trajtuar përmes nismave e iniciativave të ndryshme nga institucionet. Në bazë të Raportit "Vlerësimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (UNICEF 2019), vërehet se gjatë këtyre viteve është shtuar numri i programeve dhe trajnuesve të certifikuar ashtu sikurse është rritur numri i mësuesve të trajnuar, por nga ana tjetër ka shumë pak informacion mbi cilësinë dhe ndikimin e këtyre programeve. Gjithashtu, edhe hendeku midis orëve teorike dhe atyre praktike përbën një problem, duke filluar që në formimin e mësuesve dhe deri në trajnimet e ofruara. Një nga çështjet që kërkon mbështetje dhe zgjerim të fushës së veprimtarisë në zhvillimin profesional të mësuesve është rritja e aftësisë së tyre për të përdorur teknologjitë e reja të informacionit (TIK). Kjo ka rëndësi parësore që ata të mund të përballojnë mjedisin, realitetin që ndryshon në mënyrë të vazhdueshme ashtu edhe kërkesat e nxënësve, duke qenë se aftësitë digjitale, përdorimi dhe shfrytëzimi i TIK-ut janë ende në nivele të ulëta mes mësuesve. Krahas dokumenteve të tillë si Raporti "Vlerësimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (UNICEF 2019), nëse krahasojmë Raportet e IZHA/ASCAP, të periudhës 2016 vs 20-21 për vlerësimin e nevojave të mësuesve të zhvillimit profesional, mund të vërehet se ka një rritje të numrit të mësuesve që kanë nevoja të dosmosdoshme dhe të menjëhershme për trajnim.



Nga krahasimi i Raportit të Institutit për Zhvillimin e Arsimit (IZHA- sot ASCAP) të vitit 2016 me Raportin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar- ASCAP (2020-2021) rezulton që numri i mësuesve që kishin nevoja të dosmosdoshme/konsiderueshme për t'u përmirësuar nga pikëpamja e zhvillimit profesional ishte më i ulët në vitin 2016 (12%) në krahasim 23% në vitin 2020-2021. Nga shqyrtimi i të dhënave të lartpërmendura dhe nismat e ndërmarra në vijim, është vërejtur më pas se ministria përgjegjëse për arsimin ka bërë përpjekje që të mbështesë zhvillimin e arsimit në tërësi duke pasur në qendër mësuesin dhe nxënësin.. Por duke qenë se shoqëria po zhvillohet me një ritëm të shpejtë dhe çdo ditë përballemi me ndryshime të shumta, ka ardhur momenti që edhe mësuesi të karakterizohet nga ato aftësi që i

përshtaten mjedisit dhe nxënësit të sotëm. Për shkak se nxënësit e sotëm janë gjithnjë përballë informacioneve të reja, roli i ri i mësuesit është që t'i udhëheqë drejt përzgjedhjes, përpunimit dhe përshtatjes së këtij informacioni, i cili e ka burimin nga një mjedis e realitet global që ndryshon në mënyrë të vazhdueshme.

Seksion IV: Sfidat e zhvillimit profesional të vazhdueshëm të punonjësve arsimorë.

Zhvillimi profesional në kohë ndryshimesh, duke synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit, është një temë që konsiderohet shumë e rëndësishme nga mësuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar në Shqipëri. Të dhënat e marra nga diskutimet me këta mësues tregojnë se si pasojë e mjedisit të ndryshueshëm po shfaqen paradigma e qasje të reja në arsim. Në këtë mënyrë duhet të ndryshojnë, pasurohen dhe të përshtaten edhe tematikat, praktikat dhe aspektet metodologjike në sistemin e trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve mësuesit kanë nevojë për më shumë tema trajnimi që janë të lidhura me realitetin dinamik ku po jetojnë dhe që i vijnë në ndihmë atyre për zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies e të nxënit.Gjithashtu, mësuesit vërejnë se në përputhje me dinamikat e zhvillimit të reformës arsimore, duhet që ata të bëhen pjesë aktive e revolucionit didaktik. Mësuesit shqiptarë e lidhin mjedisin që ndryshon vazhdimisht me globalizimin, zhvillimin e teknologjisë, metodat e reja të nxënit por edhe me situata të papritura që prekin shkollën siç janë fatkeqësitë natyrore apo epidemiologjike.

Sipas vlerësimit të OECD për sektorin e arsimit në Shqipëri, mësuesit kanë nevojë për mbështetje nga jashtë dhe brenda mjedisit të shkollës nga drejtuesi i saj, për të modernizuar procesin mësimor. Në këtë kuadër ata duhet të ndryshojnë metodat e mësimdhënies nga ato tradicionale duke përdorur qasje më inovative, të cilat ndihmojnë nxënësit në procesin e tyre të të nxënit. Kjo mbështetje është veçanërisht e rëndësishme për Shqipërinë, ku ndryshimet thelbësore e të qënësishme që u bënë në vitin 2014 duke vendosur kurrikulën me bazë kompetencash, kanë ndryshuar gjithashtu pritshmërinë për rolin e mësuesit. Mësuesit priten që të përdorin metoda që vënë në qendër nxënësin, por sipas raportit të OECD, pjesa më e madhe e mësuesve nuk përdorin metoda inovative të mësimdhënies e të nxënit që ndikojnë tek formimi i aftësive të nxënësve për shekullin XXI.

Seksion V: Konkluzione

Në mënyrë që të dalin më në pah nevojat e mësuesve për zhvillim profesional në një mjedis që ndryshon vazhdimisht dhe duke synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit, Qendra "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" (CSL) hartoi këtë dokument politikash (policy paper) me qëllim përmirësimin e këtij procesi.Hartimi i këtij dokumenti është mbështetur kryesisht tek një analizë e situatës në lidhje me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe drejtuesve ashtu sikurse edhe në të dhënat e marra nga realizimi i cikleve të trajnimit me mësues e drejtues të shkollave, që organizohen nga Programi i Zhvillimit të Vazhdueshëm (CPD) pranë këtij institucioni.Qëllimi i këtij Dokumenti Politikash

Politikash (Policy Paper) është që të paraqesë një analizë të përgjithshme të aspekteve dhe sfidave të zhvillimit profesional të mësuesve në një mjedis që ndryshon vazhdimisht, përballë sfidave të globalizmit e teknologjive të informacionit, duke u mbështetur në opinionet e mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar. Në këtë mënyrë duke përdorur këto të dhëna parësore, dokumenti i politikave është në gjendje të ofrojë disa rekomandime për të përmirësuar më tej zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve e drejtuesve të shkollave, në dobi të cilësisë së procesit të mësimdhënies. Të dhënat që janë përdorur për të mbështetur analizën, konkluzionet dhe rekomandimet që janë parashtruar në këtë dokument politikash, janë marrë nga rreth 800 mësues e drejtues të institucioneve të arsimit parauniversitar në Shqipëri, të cilët morën pjesë, në ciklin e trajnimit online " Mësimdhënia dhe të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht" në datë 06 Prill-24 Maj 2021. Ky trajnim u ofrua nga Programi i Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (CPD) të Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" (CSL). Metodat e përdorura për marrjen e të dhënave përfshijnë diskutimet e hapura me pjesëmarrësit, plotësimi i pyetësorëve online dhe shkëmbimi i mendimeve e diskutimeve të hapura përmes debateve online.Tema të tilla si edukimi global, neuroedukimi, motivimi i nxënësve, mësimdhënia në nivel të lartë dhe mësimdhënia e integruar përbëjnë shtyllën kryesore të trajnimit online "Mësimdhënia dhe të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht". Të gjitha këto cilësohen si tema kyçe në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit duke u trajtuar nën këndvështrimin e një mjedisi që ndryshon vazhdimisht. Nga ana tjetër ato janë në përputhje me reformat arsimore në vend, qoftë për zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencash ashtu edhe mësimi me në qendër nxënësin. Si rezultat i të dhënave sasiore e cilësore që ofruan mësuesit e drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar që ndoqën trajnimin online "Mësimdhënia dhe të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht" u evidentuan disa konkluzione e përfundime në këtë drejtim. Një nga përfundimet lidhet me faktin se mjedisi që ndryshon ka ndikim domethënës në procesin mësimor. Për këtë arsye është e nevojshme që të ketë një vëmendje të veçantë lidhur me mbështetjen institucionale për t'a përballuar përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional këtë ndryshim. Mësuesit e kuptojnë dhe e ndjejnë risinë që ekziston në marrëdhënien midis procesit mësimor dhe mjedisit të ndryshueshëm. Por ata hasin vështirësi në harmonizimin e metodave me mjedisin e të nxënit, parimet dhe kërkesat që parashtron kurrikula e mbështetur në kompetenca.

"Realiteti mbi të cilin mbështetet procesi i mësimdhënies/nxënies është në ndryshim të vazhdueshëm; për këtë arsye duhet të vlerësojmë mënyra, forma si dhe probleme që shfaqen në këtë realitet të ri." – shprehet një mësuese.

Në këtë kuadër mund të arrihet në konkluzionin se mësuesit tanë e duan modelin e funksionimit të shkollës si organizatë dhe jo si institucion tradicional. Procesi i trajnimit, interesi, angazhimi dhe nevojat profesionale të mësuesit tregojnë

se në realitetet e ndryshimeve transformuese të arsimit po shfaqen qasje të reja. Si rrjedhojë duhet të ndryshojnë dhe të përshtaten edhe tematikat, praktikat apo qasjet metodologjike në sistemin e trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve. Për këtë arsye është e logjikshme që përgjatë procesit të zhvillimit profesional duhet të lëvrohen sa më shumë tema që përshtaten me aktualitetin dhe që i vijnë në ndihmë mësuesit për të zbatuar metodat bashkëkohore të mësimdhënies e të nxënit. Mbështetur tek idetë, propozimet, angazhimi, pasioni dhe entuziazmi i mësuesve apo drejtuesve të shkollave që ndoqën trajnimin online "Mësimdhënia dhe të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht", i realizuar nga Programi i Zhvillimit të Vazhdueshëm (CPD) të Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" (CSL), vërehet se zëri i tyre dëgjohet ende pak ndërsa shqetësimet e tyre nuk pasqyrohen në mënyrën e duhur përmes politikave që duhet të ndjekin institucionet përkatëse. Ndërkohë një nga konkluzionet e nxjerra ka të bëjë me problematikën edhe natyrën e trajnimeve, duke vënë në dukje se trajnimet e ofruara gjatë procesit të zhvillimit profesional janë kryesisht të karakterit teorik. Në këtë mënyrë bëhet e vështirë për çdo mësues që të fitojë aftësitë e duhura, për t'u përshtatur në një mjedis që ndryshon vazhdimisht. Nga reagimet e diskutimet e tyre ata shprehen se ndjehen të lodhur nga trajtimi teorik i temave tradicionale mbi mësimdhënien dhe shpesh përfshihen formalisht në këto trajnime, pasi u kërkohen kreditet e nevojshme për kualifikimin e tyre.Megjithëse ata nuk i zhvleftësojnë ato, por shprehen se janë të interesuar për tema praktike ku mund të marrin ato aftësi pedagogjike e mësimdhënëse që janë në gjendje t'i përdorin. Nga kjo pikëpamje, mësuesit theksojnë se mjedisi ku ata punojnë dhe mundësitë që u ofrohen i pengojnë për të arritur rezultatet që kërkohen, ashtu sikurse ndryshimet nuk bëhen të mundura përballë një mentaliteti dhe praktike autoritare në drejtimin e shkollës. Në këtë kuadër shprehin bindjen e tyre se nëse ju jepet mundësia ata mund të përshtaten dhe orientohen në kushtet e reja, duke krijuar një mjedis efektiv të të nxënit dhe rritur cilësinë e mësimdhënies e rezultatet e nxënësve.

Një nga përfundimet me interes është konkluzioni nga ana e tyre se nxënësit janë më të përparuar se mësuesit në aftësi të caktuara përballë mjedisit që ndryshon. Njohuritë e tyre të fituara nga veprimtari joformale, ndryshe nga ato që lidhen me formimin e kompetencave të caktuara në shkollë, duke përfshirë edhe ato dixhitale, kanë bërë që nxënësit në Shqipëri t'u përafrohen nxënësve të vendeve të zhvilluara. Mësuesit sjellin si argument faktin se shumë nxënës shqiptarë që kanë vijuar shkollimin e tyre në këto vende janë integruar lehtësisht në sistemet e tyre arsimore. Për këtë arsye ata ndjejnë nevojën që edhe vetë të përparojnë më tepër drejt konceptit të "mësuesit global" në mënyrë që të formojnë atë që sot cilësohet si "nxënësin global". Si rrjedhojë, për të arritur këtë nivel zhvillimi profesional si mësues atyre duhet t'u jepet mundësia dhe mjetet që të përshtaten, dhe orientohen në kushtet e reja, duke krijuar një mjedis të nxëni që formon këtë tipologji nxënësi.

Mësuesit ndjehen gjithashtu të shqetësuar nga realiteti se si po zhvillohet dhe po trajtohet kultura e shkollës. Ata shprehen se janë dëshmitarë të faktit se nga njëra anë është kultura e shkollës, tradita, vlera e shkollimit, parimet dhe standardet e kërkuara, ndërsa nga ana tjetër është realiteti në të cilën rriten nxënësit. Kjo mospërputhje midis vizionit dhe praktikës si funksionon shkolla dhe procesi mësimor, rrezikon krijimin e një mjedisi cilësor brenda këtij institucioni. Si pjesë e këtij arsyetimi apo përfundimi ata kanë vërejtur se integrimi i shpejtë i nxënësve në botën digjitale i ka distancuar ata nga prindërit dhe mësuesit. Për këtë arsye kanë mbërritur në konkluzionin se format, stereotipat socialë, ritet kulturore nuk mund të zhvillohen tërësisht duke u mbështetur mbi metodat tradicionale të mësimdhënies dhe të nxënit. Prandaj, mësuesit janë të interesuar për të rritur dhe thelluar njohuritë e tyre mbi këto problematika, çka bën të mundur përshtatjen dhe përballjen e tyre me realitetet që shfaqen në mikromjedisin e shkollës. Për të konkretizuar këtë përfundim, ata sjellin shembullin e zhvillimit të mësimit online gjatë periudhës së pandemisë Covid 19. Gjatë kësaj periudhe megjithëse pati problematika, vështirësi dhe ndërlikime gjatë vitit shkollor, njëkohësisht u përforcua bindja se ka ardhur koha për të bërë ndryshimet e duhura për të përballur realitete të tilla, që prekin mënyrën e funksionimit të shkollës. Situatat e jashtëzakonshme ku mësuesit u përshtatën brenda një kohe të shkurtër për të zhvilluar mësimin online, treguan se ata janë të gatshëm të përditësojnë njohuritë e aftësitë e tyre mësimdhënëse përkundër realitetit dhe mjedisit që i përball me ndryshime të papritura dhe të paparashikuara.Në këtë situatë ndryshimesh të vazhdueshme të realitetit social dhe dixhital, veçanërisht mësuesit e shkollave të arsimit të mesëm të lartë (gjimnazet) shprehin shqetësimin e tyre se nuk kanë trajnimin e mjaftueshëm për t'u përballur siç duhet në lidhje me aspektet e praktikat e komunikimit me nxënësit. Ata pohojnë se në gjimnaze procesi mësimor është intensiv dhe përcjell stres e pasiguri tek nxënësit. Ndërkohë mësuesve u mungojnë teknikat psiko-pedagogjike që të zbulojnë instrumentet e duhura drejt zbërthimit të botës së brendshme të nxënësve, në mënyrë që ti motivojnë dhe angazhojnë në procesin mësimor. Konfliktet dhe mosbindja e nxënësve përgjatë mësimdhënies online shtrihet edhe në familje me prindërit, të cilët ankohen edhe më shumë në këtë drejtim. Kjo ka të bëjë më shumë me sjelljen e fëmijëve në familje se sa më qëndrimin e tyre ndaj shkollës. Në këtë rast mësuesit hasin vështirësi edhe për të patur në krah të tyre prindërit, për të menaxhuar siç duhet sjelljet e nxënësve problematikë.Gjithashtu, njëra nga problematikat e konkluzionet e nxjerra nga mësuesit e drejtuesit të institucioneve të arsimit parauniversitar që ndoqën trajnimin online "Mësimdhënia dhe të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht", (realizuar nga Programi për Zhvillim Profesional të Vazhdueshëm (CPD) të Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar", (CSL) lidhet me faktin se mësuesit duan të njohin më mirë nevojat e nxënësve të tyre. Për rrjedhojë ata shfaqin interes për tema të zhvillimit të vazhdueshëm

profesional që kanë të bëjnë me aspekte të psikologjisë së zhvillimit dhe neuro-edukimin.Në këtë kuadër vërehet se mësuesit kanë përcaktuar si element të rëndësishëm motivimin e brendshëm që përcjell tek nxënësi energji pozitive, dashuri për lëndën dhe punën e tij. Për këtë arsye, ata vlerësojnë rëndësinë e trajtimit të kësaj teme dhe mënyrat si t'i zbatojnë teknikat që ushqejnë motivimin e brendshëm tek nxënësit e tyre. Nga ana tjetër, neuroedukimi nëpërmjet parimit të "mësuesit si neuro edukues" është një mundësi e mirë për të kuptuar dhe zbatuar teknikat për motivimin e brendshëm dhe zhvillimin e të menduarit të një niveli të lartë. Nxitja e klimës miqësore brenda në klasë dhe mjediset e shkollës, ndërveprimi dhe angazhimi i nxënësve mbeten prioritetet e shqetësimet kryesore të mësuesve. Në mënyrë që ata të materializojnë këta elementë brenda ambienteve ku ushtrojnë aktivitetin e përditshëm mësimdhënës, është i nevojshëm zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale që kanë në qendër shtjellimin teorik e zbatimin e tyre në praktikë. Mësuesit e drejtuesit e shkollave besojnë dhe kanë bindjen se psikologjia e zbatuar dhe neuroedukimi shihen si burim i ndërtimit të strategjive të reja konstruktiviste, të cilat bëjnë të mundur përvetësimin dhe realizimin konkret të teknikave dhe metodave të mësimdhënies së integruar.. Nëpërmjet këtij procesi dhe praktikës didaktike që e shoqëron atë, mund të arrihen rezultate të larta për të menduarin në nivel të lartë, të vetëdijshëm dhe afatgjatë tek nxënësit.. Për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave mbetet parësor fakti se para njohurive mbi mënyrën sesi motivohen, respektohen dhe edukohen nxënësit me vlera qytetare, njohuri shkencore dhe kompetenca jetësore, është shumë e nevojshme të njihet prej tyre se si funksionon truri i nxënësit, si arrihet komunikimi i suksesshëm me ta dhe krijimi i një klime miqësore dhe mjedisi sa më tërheqës brenda në klasë apo në shkollë. Mësuesit shprehen se neuroedukimi shkrin ngërçin e vështirësive që lidhen me përfshirjen e të gjithë niveleve të nxënësve në procesin mësimor. Kjo ndodh pasi ai integron njohuritë ndërlëndore dhe jetësore duke bërë të mundur e lehtësuar gjithëpërfshirjen e nxënësve në orën e mësimit.

"Mendoj që mësimdhënia e bazuar në parimet e neuroedukimit ka efektivitet më të lartë sepse ndihmon mësuesin të njohë dinamikën mendore të nxënësit dhe në varësi të saj të vendosë nivelin e kërkesës ndaj tij; trajton si të mirëqenë faktin që nxënësit janë të ndryshëm në aftësinë për të nxënë; redukton efektin stres i dëmshëm duke krijuar një klimë pozitive dhe të qetë në formimin e një personaliteti të qëndrueshëm." – shkruan një mësuese.

Megjithëse kurrikula aktuale e ushqen këtë mundësi me filozofinë dhe hapësirat që i lejon mësuesit, ai ka nevojë për trajnim dhe kualifikim të vazhdueshëm profesional në mënyrë që të përmbushë pritshmëritë lidhur me këtë parim të mësimdhënies.

"Neuroedukimi më shumë sesa një mjet është një qasje për trajtimin dhe zhvillimin e të nxënit, mbi bazat e zhvillimit cerebral dhe atij emocional."- shkruan një mësuese.

Në vijim të konkluzioneve e përfundimeve që kanë dalë nga intervistat me mësues e

drejtues të shkollave që ndoqën ndoqën trajnimin online "Mësimdhënia dhe të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht", (i realizuar nga Programi për Zhvillim Profesional të Vazhdueshëm (CPD) të Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" CSL), është theksuar mes të tjerave nevoja për të qartësuar dhe thelluar njohuritë mbi disa koncepte që lidhen me zbatimin e kurrikulës.Shpesh mësuesit i konsiderojnë konceptet e "Mësimdhënies së Integruar" dhe "Mësimdhënies Ndërlëndore", si pjesë përbërëse të së njëjtës kërkesë. Ata kanë qartësuar faktin se mësimdhënia e integruar dhe ndërlëndore, i aftëson nxënësit ta shohin botën si një sistem dhe ta projektojnë veten e tyre si pjesë e tij. Mirëpo ata shkojnë edhe më tej, duke theksuar se mësimdhënia e integruar kërkon, veç të tjerash, edhe integrimin në metodat e mësimdhënies. Të nxënit e integruar ka të bëjë me mënyrën se si integrohen format e të nxënit ndërlëndor, për të realizuar studimin e një problemi, dhe zgjidhjen e tij. Nëse punojmë në njësi të cilat kanë në thelb njohuri nga disiplina të ndryshme, nëse përdorim metoda të larmishme për të realizuar mësimin, do të thotë se këtu kemi të bëjmë dhe me integrimin në metodë. Ky integrim në metodë ndihmon që nxënësit të realizojnë vetëvlerësime gjithnjë e më cilësore. Integrimi në metodë është një çelës didaktik shumë i fuqishëm për të zhvilluar mendimin logjik të nxënësve në të gjitha lëndët. Në këtë rast ky konceptim i mësuesve dëshmon dhe një herë për nevojën që të thellohet perceptimi mbi qasjet e reja të mësimdhënies.Mbështetur në diskutimet, analizat dhe reagimet e vërejmë se ata e konsiderojnë mendimin kritik si stacion dhe jo si destinacion i procesit të mësimdhënies në shkollat shqiptare. Ata e mbështesin plotësisht mendimin se zhvillimi i mendimit kritik tek nxënësit jep mundësi reale për realizimin e kurrikulës me bazë kompetencash, aftëson nxënësin për të zgjidhur probleme dhe u jep mundësi atyre dhe mësuesve të vijojnë edukimin gjatë gjithë jetës.

Nxënësi duhet të mësohet të kuptojë botën dhe të përshtatet me të në mënyrë kritike dhe me filtra didaktikë"-shprehet një mësuese.

Në këtë drejtim theksohet fakti që mësimdhënia e mbështetur në mendimin kritik dhe atë kreativ jep mundësi që nxënësi të formojë e të forcojë mendimin e vet të pavarur. Në fund të fundit, të dy llojet e mendimit mbështeten në vlera intelektuale universale që shkojnë përtej ndarjeve sipas lëndëve shkollore.

Seksion VI: Rekomandimet

Dokumenti i Politikave "Zhvillimi i vazhdueshëm profesional në kohë ndryshimesh:Mbështetja e mësuesve dhe drejtueseve të institucioneve të arsimit parauniversitar si të përballen me ndryshimin", parashtron një sërë konkluzionesh dhe përfundimesh që kanë në bazë një analizë të përgjithshme të procesit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional ashtu sikurse edhe të dhënat që kanë dalë nga mësuesit apo drejtuesit e shkollave që ndoqën trajnimin online, "Mësimdhënia dhe të nxënit në një mjedis që ndryshon vazhdimisht", i realizuar nga Programi i Zhvillimit

Profesional të Vazhdueshëm (CPD) të Qendrës "Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar" (CSL), 6 Prill-24 Maj. Këto rekomandime synojnë të nxisin ndërmarrjen e politikave dhe iniciativave nga ana e MAS lidhur me përmirësimin dhe fuqizimin e procesit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësues/drejtues. Në këtë mënyrë, ata do të kenë aftësitë e duhura dhe të përditësuara pedagogjike, psikologjike, etike e dixhitale për të përballur realitetin e mjedisin që i rrethon, i cili është në ndryshim të vazhdueshëm falë globalizmit ekonomik, teknologjik dhe sjell sfida të ndryshme brenda mjedisit të shkollës. Në këtë rast rekomandimet përfshijnë aspekte të ndryshme të zhvillimit profesional e të menaxhimit të institucioneve të arsimit parauniversitar, të tilla si më poshtë:

1. Shkollat duhet të nxisin dhe planifikojnë procesin e zhvillimit profesional të stafit të tyre mësimor në mënyrë të koordinuar dhe t'u japin atyre kohën e duhur për këtë proces.

Ky dokument politikash sugjeron që një nga prioritetet kryesore të shkollave të jetë planifikimi i zhvillimit profesional të mësuesve në mënyrë të koordinuar, duke iu vënë më shumë kohë në dispozicion dhe duke i orientuar drejt aktiviteteve efektive dhe jo tradicionale të zhvillimit të tyre. Kjo qasje ndikon pozitivisht në motivimin e mësuesve dhe promovon bashkëpunimin profesional midis tyre.

2. Angazhimi dhe përfshirja e mësuesve në menaxhimin dhe drejtimin e shkollës.

Një nga rekomandimet kryesore të këtij dokumenti është rritja e përfshirjes së mësuesve në hartimin e dokumenteve strategjikë dhe në proceset vendimmarrëse të shkollës, duke marrë në konsideratë që mësuesi është në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me nxënësit dhe trajton problematika konkrete sipas nevojave të tyre. Në mënyrë që të arrihet përfshirja domethënëse e mësuesve në këto procese, është e nevojshme që të krijohet në shkollë një mjedis i përshtatshëm që favorizon ndryshimet përballë mentalitetit dhe praktikave autoritare në drejtimin e shkollës. Mundësimi i aktiviteteve bashkëvepruese në shkollë, vendimmarrjet e hapura, transparenca dhe përfshirja e ideve të mësuesve, do t'u hapë rrugë krijimit të qasjeve të reja dhe mënyrave se si ata mund të krijojnë një mjedis efektiv të të nxënit.

3. Trajnimet profesionale të mësuesve dhe drejtuesve kanë nevojë të përmirësohen.

Cilësia e trajnimeve të ofruara është një nga çështjet e rëndësishme që duhet marrë në konsideratë nga subjektet ofruese të këtyre trajnimeve. Për këtë arsye rekomandohet që të shmangen tematikat teorike-akademike, pasi nuk i ndihmojnë ata mjaftueshëm në zgjidhjen e situatave problemore që hasin gjatë punës së tyre në shkollë. Agjencitë trajnuese duhet të projektojnë zbatimin e qasjeve teorike në praktikën aktuale dhe në situata problemore reale.

Për këtë rekomandohet që trajnimet të kategorizohen në trajnime të organizuara për zhvillimin profesional në kuadër të zbatimit dhe të përvetësimit të kurrikulës dhe në trajnime me zgjedhje, që mundësojnë zhvillimin e ambicjeve individuale të mësuesve.

Gjithashtu, universitetet që përgatisin mësues, institucionet e zhvillimit profesional si dhe ekspertët e edukimit duhet të

bashkëpunojnë në mënyrë të vazhduar për të përcjellë një informacion të thelluar mbi këto tematika. Vlefshmëria e tyre duhet të shoqërohet me këshilla praktika, modele dhe udhëzime të zbatueshme në procesin mësimor.

4. Krijimi i kushteve optimale që mësuesi shqiptar të zhvillohet si "mësues global".

Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe krijimi i hapësirave për t'u vetëzhvilluar profesionalisht krijon kushtet për formimin e mësuesit global. Rekomandohet që politikat arsimore të planifikojnë investime në infrastrukturën e shkollave për zgjerimin e hapësirave, shmangien e mësimit me turne, uljen e numrit të nxënësve në klasë dhe zbutjen e ndryshimeve midis punës së mësuesve në zonat rurale, në krahasim me ato të zonave urbane.

Drejtorive të shkollave, u rekomandohet që të krijojnë strategji që i motivojnë mësuesit për të plotësuar standardet e mësuesit global, rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të mësuesve për rolin e rëndësishëm që ato kanë në shoqëri, shmangien nga kushtëzimi i faktorëve të tjerë me karakter social, ekonomik, kulturor, politikë për të qenë "mësues global". Rekomandohet që drejtoritë e shkollave të fuqizojnë klimën miqësore në shkollë, ku mësuesit të shprehin lirisht mendimet dhe idetë e tyre. Drejtorët të kenë më shumë besim te mësuesit dhe t'u delegojnë më shumë përgjegjësi dhe forcë në vendimmarrje. Në këtë drejtim rekomandohet rritja e vullnetit dhe e përpjekjeve reale për të ulur nivelin e lartë të centralizimit të sistemit arsimor parauniversitar shqiptar.Thelbi i decentralizimit rekomandohet të jetë me në qendër shkollën. Pra procesi i vendimmarrjes në sistemin e arsimit parauniversitar nga koncepti "për shkollën", të realizohet "brenda shkollës". Aktorët brenda shkollës mund dhe duhet të marrin më shumë përgjegjësi për mbarëvajtjen e punës mësimore-edukative të këtij institucioni.

5. Zhvillimi i aftësive komunikuese të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, në arsimin e mesëm të lartë për të lehtësuar marrëdhënien me nxënësit e kësaj grupmoshe.

Aftësitë komunikuese janë të rëndësishme në arsimin e mesëm të lartë (gjimnaz) dhe për këtë arsye duhen zhvilluar trajnime të vazhdueshme, në fushën e komunikimit me mësuesit dhe drejtuesit, në mënyrë që ata të përsosin komunikimin në raport me nxënësit dhe prindërit. Për mësuesin/drejtuesin është shumë e rëndësishme të dijë se si të orientohet dhe të ketë mekanizmat dhe instrumentet e nevojshme për të zbuluar botën e brendshme të nxënësve, t'i motivojnë dhe angazhojnë ata në mënyrë të vazhdueshme.

Mësuesit kanë përcaktuar si element të rëndësishëm motivimin e brendshëm që përcjell tek nxënësi energji pozitive, interes për lëndën dhe punën e tij. Për këtë arsye, ata vlerësojnë rëndësinë e trajtimit të temave që lidhen me aftësitë e komunikimit dhe si t'i zbatojnë ato që të nxisin motivimin e brendshëm tek nxënësit e tyre.

6. Agjencitë trajnuese të krijojnë module trajnimi për mësimdhënien e integruar duke nxitur dhe zbatuar parimin e integrimit në metodat e mësimdhënies.

Mësuesit e ndjejnë dhe e kuptojnë se "mësimdhënia e integruar" mbështetet më shumë tek integrimi dhe lidhja mes fushave të dijes dhe të të nxënit, sesa ato

mes lëndëve. . Po ashtu, sipas tyre "mësimdhënia e integruar "ka në qendër stilet e të nxënit dhe inteligjencat e shumëfishta, duke u mbështetur tek ndërveprimi dhe bashkëpunimi. Praktika dhe përvoja ka dëshmuar se motivimi i jashtëm, kontrolli me disiplinë dhe mbingarkesa nuk ka sjellë rezultatet e dëshiruara. Si rrjedhojë, ata e kanë kuptuar tashmë se menaxhimi i nxënësve duhet të jetë nëpërmjet motivimit të brendshëm. Për këtë arsye rekomandohen që trajnimet duhet të thellohen jo vetëm në aspektin e njohurisë së koncepteve, por më së shumti në ndikimin e tyre gjatë zbatimit në praktikë.

7. Gjetja e formave të reja të përfshirjes e prindërve në jetën shkollore.

Bashkëpunimi mësues-nxënës-prind ndikon në mbarëvatjen e procesit mësimor dhe ecurinë e nxënësit në shkollë. Në këtë kuadër përfshirja e prindërve dhe bashkepunimi me to ndikon pozitisht edhe në klimën e përgjithshme të shkollës.

Zhvillimi i teknologjisë së komunikimit, përfshirja aktive e fëmijëve dhe të rinjve në botën dixhitale ka distancuar nxënësit si nga prindërit ashtu edhe nga mësuesit. Format, praktikat dhe modelet tradicionale të punës për përfshirjen e prindërve, duhen të riformatohen dhe përshtaten me kërkesat e kohës. Prandaj rekomandohet që të gjenden forma të reja dhe të hartohen strategji për rritjen e kapaciteteve të përfshirjes së prindërve në shkollë. Specialistët e shkencave të edukimit të trajtojnë dhe diskutojnë tema mbi këto aspekte problematike që shqetësojnë mësuesit dhe ngjallin interes për prindërit.

Seksion VII: Referenca

Gordon, S. P. (2004). Professional development for school improvement. Pearson. USA.

Hassel, E. (1999). Professional development. Learning from the best. North Central Regional

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, (MASR). 2012. Ligjin Nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar)

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, (MASR). 2004. Strategjiia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2004-2015

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, (MASR). 2009. Strategjive Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2009-2013

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, (MASR). 2014. Strategjive Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2014-2020

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, (MASR). 2020. Strategjive Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2020-2026

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). 2020. Raporti i Arritjeve ASCAP 2017-2020;

Ëort, M. & Pupovci, D. & Ikonomi, E. 2019. Raporti "Vlerësimit të Strategjisë të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (UNICEF)

Instituti i Zhvillimit të Arsimit. 2016. Identifikimi i nevojave për trajnimin e drejtuesve dhe mësuesve të shkollave në Arsimin Parauniversitar

Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), 2021. Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar

Maghnouj, S. et al. (2020), OECD Revieës of Evaluation and Assessment in Education: Albania, OECD Revieës of Evaluation and Assessment in Education, OECD Publishing, Paris, https://-doi.org/10.1787/d267dc93-en.

Boeskens, L. Lieboëitz, D. Minea-Pic, A. Nusche, D. Radinger, TH. 2020. OECD Education Policy Perspective. Professional groëth in times of change: Supporting teachers' continuing professional learning and collaboration.

Hartuar nga:
Prof.Asoc.Dr. Tomi TRESKA
Dr. Zenel SINA

Procesi u koordinua nga:
MSC. Kledia LIKA
PhD Student. Vahidije KADIU

Tiranë, 2022